



PARTIA EGJIPTIANE
IRDK

PLATFORMA POLITIKE

Parimet themelore

Vizioni

Pjesëtarët e Komunitetit Egjiptian në Kosovë do të jenë qytetarë të Kosovës, ku: atdheu i vetëm i tyre është Republika e Kosovës; shteti iu garanton liri, jetë me dinjitet dhe barazi; shoqëria nuk do t'i paragjykoj për shkak të ngjyrës dhe përkatësisë etnike; deklarimi etnik të jetë i unifikuar dhe tradicional; solidariteti dhe vendosmëria për barazi sociale brenda komunitetit do të jetë vetëdije kolektive.

Gjendja aktuale

Shoqëria kosovare vazhdon të jetë në proces të transformimit nga një shoqëri që doli nga lufta, në një shoqëri me vlera që bartin shoqëritë e vendeve euro atlantike. Shteti i Kosovës nuk po merr masa të duhura për të garantuar barazi sociale dhe jetë të dinjitetshme për të gjithë. Shoqëria e Kosovës vazhdon të bartë paragjykime për komunitetin tonë, të cilat manifestohen me përbuzje të komunitetit dhe diskriminim nga ana e institucioneve. Për shkak të paragjykimeve të shoqërisë karshi komunitetit, është evidente papunësia shumë e lartë dhe si rrjedhojë edhe kualiteti i ulët i jetesës te një pjesë e konsiderueshme e komunitetit.

Deklarimet etnike si Egjiptian e Ashkali, janë shndërruar në elemente politike nga përfaqësuesit politik të cilët po tregohen të pa aftë për të formalizuar identitetin etnik të unifikuar.

Pjesëtarët e komunitetit tonë vazhdojnë të jetojnë të ndarë në grupin që jetojnë në varfëri të skajshme dhe në grupin me standard të mesëm. Përgjegjësia e shtetit dhe solidariteti me pjesëtarët që jetojnë në varfëri të skajshëm, është shumë i ulët.

Sfidat

- Paragjykimet e shoqërisë ndaj komunitetit
- Mos gatishmëria e shtetit për të garantuar jetë të dinjitetshme
- Deklarimi etnik i ndarë për motive politike
- Kualiteti i ulët i jetesës për një pjesë të konsiderueshme të komunitetit

1. Atdheu ynë i vetëm është Kosova

Në Kosovë, ne si grup etnik, jemi autokton. Si pjesë e shoqërisë së këtij vendi kemi kapërcyer nëpër shumë sfida. Kemi qenë aktiv në shtet ndërtimin e Kosovës dhe tani bëjmë politikë për të qenë qytetar të barabartë të Kosovës si atdheu ynë i vetëm.

Si pjesë aktive e shoqërisë së Kosovës, do të kontribuojmë për avancimin e strukturave të shtetit të Kosovës duke qenë pjesë a tyre. Pjesëmarrja jonë në sigurinë e Kosovës duhet të jetë më e madhe duke qenë numerikisht më shumë pjesë e strukturave të Policisë së Kosovës, Forcave të Armatosura dhe Agjencisë së Inteligjencës. Mbështesim plotësisht synimet e shoqërisë që Kosova të jetë anëtare e Bashkimit Evropian dhe NATO, prandaj do të kontribuojmë për plotësimin e kritereve që vendosen në procesin e integritimeve euro atlantike. Gjithashtu do të jemi kontribut-dhënës në zhvillimin kulturor të shoqërisë së Kosovës përmes shtytjes së komunitetit për të qenë aktiv në grupe kulturore, artistike dhe sportive.

2. Liria, dinjiteti dhe barazia

Liria

Liria është një e drejtë themelore e njeriut që lind së bashku me të. Shoqëria është e lirë përderisa individët dhe komunitetet që jetojnë me të janë të lirë. Shtypja, kufizimi dhe privimi nga të drejtat themelore të njeriut, diktatura, varfëria, papunësia, mungesa e strehimit dhe injoranca janë armiqtë e lirisë. Ne angazhohemi që të gjithë individët dhe komunitetet të gëzojnë standarde të njëjta të lirisë. Jemi kundër stigmatizimit të individëve mbi bazën e kategorisë shoqërore, përkatësisë etnike, fesë, gjinisë apo racës. Për ne, liria është e plotë kur ajo i takon secilit dhe çdo individ, duke përfshirë ata që mendojnë ndryshe. Ne besojmë në përcaktimin e Deklaratës Universale të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut se: “të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta”.

Dinjiteti

Konsiderojmë që dinjiteti kërkon që individët të vendosin në mënyrë të pavarur për mënyrën sesi duhet të jetojnë dhe kanë përgjegjësi ndaj vetvetes dhe komunitetit për kushte normale jetese, pasi që individit është i pavarur nga kapaciteti dhe aftësitë individuale.

Barazia sociale

Ne angazhohemi për politika sociale të cilat mbulojnë të gjitha dispozitat dhe masat që synojnë të parandalojnë, të mënjanojnë ose të lehtësojnë situatat e varfërisë dhe problemet sociale, në nivel individual ose kolektiv, ose që kërkojnë të favorizojnë mirëqenien e grupeve më të brishta të shoqërisë. Angazhimi për politika sociale duhet të përcaktoj masa që shërbejnë drejtpërdrejt në luftën kundër varfërisë ose parandalimin e saj, në radhë të parë ndihma sociale, si dhe pagesa të tjera në varësi të burimeve të mundshme. Gjithashtu, në politikën sociale duhet përfshihen edhe fusha tjera, të tilla si

politika e tregut të punës dhe e punësimit, politika e arsimimit, e shëndetit, e strehimit, ose edhe politika fiskale. Shteti i Kosovës duhet që të kryej edhe funksione të ndërhyrjes dhe të rregullimit në fushat ekonomike dhe sociale. Kjo duhet shprehur nëpërmjet një tërësie masash që kanë për qëllim rishpërndarjen e pasurive dhe marrjen përsipër të rreziqeve të ndryshme sociale, si sëmundjet, varfërinë, pleqëria, punësimi dhe familja. Shteti i Kosovës duhet të bazohet mbi solidaritetin midis grupeve shoqërore të ndryshme dhe në kërkimin e drejtësisë sociale. Objektivat e politikës sociale duhet të përfshijnë: drejtësinë sociale (paanësia, barazia e shanseve) sigurimin social (mbrojtjen kundër rreziqeve të mëdha të ekzistencës) paqen sociale rritjen e prosperitetit dhe pjesëmarrjen më të gjerë në këtë prosperitet të përbashkët. Sfidat e shoqërisë së Kosovës janë: puna, punësimi, formimi profesional, mbrojtja sociale dhe siguri shëndetësor, arsimi, personat në vështirësi (lypësit, të pastrehët, etj.), personat e moshuar. Përveç politikave sociale të përgjithshme, në Kosovë, duhet zhvilluar edhe ndërhyrje specifike me fokus te personat në vështirësi. Lufta kundër përjashtimit duhet bazohet në zhvillimin e politikave të ndihmës sociale duke rishikuar kriteret për të qenë përfitues i ndihmës sociale dhe të veprimit social. Në këtë mënyrë ne angazhohemi për politika ekonomike të cilat i dalin në krah shtresave më të ulëta të shoqërisë, bizneseve të vogla dhe familjare, fermerëve dhe të pa punësuarve.

3. Rritja e nivelit të arsimimit për t'i ulur paragjykimet

“Të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira dhe të barabarta nga pikëpamja e dinjitetit dhe e të drejtave. Ato janë të pajisura me arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të veprojnë njëra ndaj tjetrës në një frymë vëllazërie.” - Neni 1 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.

Deklarata universale e të drejtave të njeriut, e cila pjesë e kornizës ligjore në Kosovë, duhet të na shërbej si parim themelor në adresimin e çështjeve që ndërlidhen me marrëdhëniet ndër njerëzore në shoqërinë e Kosovës.

Paragjykimet lidhur me pjesëtarët e komunitetit tonë janë evidente dhe burimin e kanë te racizmi, nacionalizmi, mendjemadhësia, etj. Shtrembërimi, keqkuptimi, shpërfillja e fakteve të cilat nuk përputhen me mendimet e formuluar më parë për një individ që ka një etni apo ngjyrë tjetër, janë të dëmshme dhe mund të përcillen me pasoja në shoqëri. Prandaj duhet gjetur masa mbrojtëse për të minimizuar pasojat që mund të reflektohen te komuniteti nga dukuria e paragjykimeve.

Konsiderojmë se arsimimi është “arma më e fuqishme” në luftën kundër paragjykimeve. Përmes arsimimit të duhur mund të dalin në dritë shkaqet e rrënjësura të paragjykimeve, mundësohet që të shqyrtohen qëndrimet tona në mënyrë objektive dhe ndihmon në përbalimin me mençuri të paragjykimeve, atëherë kur jemi viktimë e tyre.

Përkushtim i vazhdueshëm do të mbetet regjistrimi i të gjithë fëmijëve në nivelin para shkollor dhe fillor, mos braktisja e shkollimit dhe vazhdimi i shkollimit të mesëm dhe të lartë. Institucionet adekuate të arsimit duhet zbatuar kornizën ligjore lidhur me detyrimin e vijimit të shkollimit. Fenomeni i braktisjes së shkollimit, në veçanti i shkollimit fillor, është dukuri që përcjell komunitetin tonë. Kjo dukuri e dëmshme për fëmijët, familjen, komunitetin dhe shoqërinë është e theksuar në veçanti te familjet që jetojnë në kushte të vështira ekonomike. Parandalimi i braktisjes së shkollimit dhe vijueshmëria e mësimin të familjet që jetojnë në kushte të renda sociale dhe fëmijët jetim është komplekse dhe duhet zbatuar masa të caktuar për parandalimin e kësaj dukurie. Për këtë dukuri, Qeveria e Kosovës duhet hartuar strategji të veçantë për shkollim të familjeve me varfëri të skajshme, duke planifikuar dhe ndarë fond të veçantë për stimulimin e kësaj kategorie, në mënyrë që fëmijët të vijojnë shkollimin, duke iu siguruar një ndihmë në baza mujore. Kushtëzimi i dhënies së stimulimit me vijueshmëri të shkollimit fillor do të zvogëloj në masë të madhe dukurinë e braktisjes së shkollimit fillor.

Konkurrenca nganjëherë e pa përballueshme për regjistrim në shkollën e mesme të nxënësit e komuniteti tonë karshi shumicës, shtron nevojën e rezervimit të një kuote në shkollat e mesme në gjuhën shqipe. Në këtë kuotë të rezervuar duhet lejuar konkurrencën e nxënësve të komunitetit. Konsiderojmë se shkollimi i nxënësve në shkollat profesionale krijon parakushte për punësim më të lehtë pas përfundimit të shkollës së mesme.

Duhet inkurajuar krijimin e klubit të studenteve, që do të ishte lidhje në mes tyre me qëllim të bashkëpunimit, ofrimin e ndihmës për njeri tjetrit, interesimi për bursa dhe forma tjera të bashkëpunimit me qëllim të arritjes së sukseseve në studime dhe faktorizimin e studentëve egjiptian në Senatën e Universiteteve Publike.

4. Deklarimi etnik i unifikuar dhe tradicional

Deklarimi publik lidhur me përkatësinë etnike të grupi tonë etnik, në vitet pas luftës në Kosovë a shkaktuar konfuzion në publik, dhe pakënaqësi te komuniteti. Deklarimi si Egjiptas dhe Ashkali, ka bërë që formalisht të identifikohemi me shkurtesa. Si pasojë e kësaj, identiteti ynë etnik, formalisht mbetet jashtë realiteti.

Argumenti kryesor për unifikimin e deklaramit të etnisë tonë duhet të merret identiteti ynë tradicional, ndërsa me zbulimin e prejardhjes tonë duhet të merret shkenca. Grupi jonë etnik, të deklaruar Egjiptas dhe Ashkali, ka një identitet të veçantë, ndërsa të vërteten shkencore mbi prejardhjen tonë etnike nuk duhet të manipulohet politika. Të mësuarit lidhur me prejardhjet tonë do të na shërbej që të jemi krenar lidhur me rrënjët tona, ndërsa mbetet të vazhdojmë të kultivojmë traditat tona në trojet tona shekullore, duke mos u ndier ardhacak.

Ndarja formale e grupit tonë etnik të grupacionet Egjiptian dhe Ashkali është bërë më shumë me motive politike. Unifikimi i deklaramit etnik duhet të jetë politik, duke bërë ndryshime të vogla në Kushtetutë, aty ku përcaktohen vendet e garantuara sipas përkatësisë etnike.

5. Solidariteti dhe vendosmëria kundër varfërisë

Komuniteti ynë, aktualisht, jeton i ndarë në dy shtresa sociale: shtresa me një standard të mesëm dhe shtresa me varfëri të skajshme. Asnjëra prej dy shtresave nuk është e përjashtuar nga paragjykimet dhe pasojat e saj, ndërsa parametrat social të shtresës së dytë, nga shoqëria civile i mveshet gjithë komunitetit, duke e ranguar komunitetin në kategoritë sociale të marginalizuar.

Kategoria sociale me standard të mesëm nuk tregon solidaritet me të varfëritë e komunitetit tonë dhe shpreh një distancë e cila manifestohet edhe me paragjykimet. Kategoria e mesme duhet të marrë përsipër homogjenizimin social brenda komunitetit tonë përmes solidaritetit dhe angazhimit në aktivitete politike dhe të shoqërisë civile për të tejkaluar vështirësitë.

Homogjenizimi social i komunitetit do të jetë shumë i dobishëm për të pakësuar manifestimin e paragjykimëve ndaj komunitetit.